



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Bulevardi "Zogu I", Godina 57/2, Nr.18 Tirane

Tel/Fax 04 2226814 ; 2226814

Nr 719/5 akti

Tiranë 30.12 2015

V E N D I M

Nr 137 , datë 30.12 /2015

**Mbi përfundimin e hetimit administrativ, filluar me Urdhrin e verifikimit
nr. 719/1 prot., datë 16.11.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil**

Në mbështetje të neneve 11, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar dhe nenin 13, 14 gërma "a" dhe 34 të Rregullores "*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*", miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të materialit të administruar dhe relacionit të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, mbi verifikimin e kryer në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë në momentin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës me institucionin e Bashkisë Bulqizë, për punonjësin ***** , u kryen procedurat e hetimit administrativ dhe në përfundim të tyre,

VËREJ SE:

Në datën 23.10.2015, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka marrë dijeni për ndërprerjen e marrëdhënies së punës për shkak të ristrukturimit për punonjësin ***** , nëpunës civil në Komunën Zerqan. Me Urdhrin nr.719/1 prot., datë 16.11.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, filloi verifikimi mbi zbatimin e ligjshmërisë në momentin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës.

Punonjësi ***** , ka filluar punë në Komunën Zerqan, me Vendimin nr. 17, datë 02.05.2007, të Kryetarit të Komunës Zerqan, "*Për emërim në punë*", në detyrën "*Përgjegjës i Zyrës së Taksave*". Kjo marrëdhënie punësimi, vlerësohet e ligjshme pasi, në këtë kohë komunat si njësi vendore, nuk ishin pjesë e shërbimit civil e për pasojë, nuk ishte i detyrueshëm zbatimi i procedurave të rekrutimit në shërbimin civil.

Pas fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*" (i ndryshuar), i cili i përfshiu dhe komunat në fushën e shërbimit civil, në zbatim të nenit 67, pika 3 të tij dhe Kreut II, pika 2, të VKM nr. 116, datë 05.03.2014, "*Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil*", këtij punonjësi i ka lindur e drejta e përfitimit të statusit të nëpunësit civil në periudhë prove, për shkak të ligjit. Për këtë arsye, njësia e personelit , me aktin nr.428, datë 30.12.2014, ka deklaruar statusin e punësimit për këtë punonjës, si nëpunës civil në pozicionin "*Përgjegjës i Zyrës së Taksave dhe Jurist*".

Bazuar në ndarjen administrativo-territoriale të përcaktuar në ligjin nr. 115/2014, "*Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë*", Komuna

Zerqan, është përfshirë në procesin e riorganizimit të njësive të qeverisjes vendore, duke u bërë pjesë e strukturës dhe organikës së Bashkisë Bulqizë, si Njësi Administrative.

Në vijim të këtij procesi, mbështetur në ligjin nr. 30/2015, *“Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”*, Këshilli Bashkiak i Bashkisë Bulqizë, me Vendimin nr. 8, datë 10.08.2015 *“Për miratimin e numrit të punonjësve të Bashkisë dhe institucioneve në varësi dhe të njësive administrative”*, ka miratuar numrin e punonjësve të Bashkisë Bulqizë, duke përcaktuar se Njësia Administrative Zerqan do të pësonte shkurtim të numrit të përgjithshëm të vendeve të punës, nga 16 që kishte struktura e mëparshme, në 9 punonjës në strukturën e re, prej të cilëve vetëm 5 pozicione pune do të bënin pjesë në shërbimin civil.

Nisur nga ky vendim i këshillit bashkiak, i cili ka në thelb shkurtimin e numrit të përgjithshëm të pozicioneve të punës, Kryetari i Bashkisë Bulqizë, me aktin nr. 57, datë 12.08.2015, *“Për ndërprerjen e marrëdhënies së punës për punonjës me kontratë pune, për shkak të shkrirjes së Komunës Zerqan dhe ristrukturimit të Bashkisë Bulqizë”*, ka urdhëruar ndërprerjen e marrëdhënies së punës për disa prej punonjësve ekzistues, ndër të cilët figuron edhe punonjësi ***** , me arsyetimin se ata kanë qenë të punësuar me kontratë.

Ky punonjës, ka kundërshtuar aktin e mësipërm, me pretendimin se është nëpunës civil dhe duhej të trajtohej si i tillë gjatë procesit të riorganizimit të njësisë administrative, duke kërkuar për këtë edhe ndërhyrjen e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për rivendosjen e gjendjes së ligjshmërisë.

Nga hetimi administrativ i kryer, vërehet se, trajtimi i këtij punonjësi si i emëruar me kontratë dhe për pasojë ndërprerja e marrëdhënies së punës për këtë shkak, është veprim administrativ që vjen në kundërshtim me ligjin.

Është e vërtetë që sipas strukturës organizative të miratuar nga Kryetari i Bashkisë Bulqizë me Urdhrin nr. 54, dt.11.08.2015, evidentohet shkurtim i numrit të përgjithshëm të nëpunësve civilë duke përfshirë edhe pozicionin e mëparshëm të punës së punonjësit ***** , si *“Përgjegjës i Zyrës së Taksave”*, por në këtë rast Kryetari i Bashkisë, nuk mund të urdhëronte ndërprerjen e marrëdhënies së punës. Në kushtet kur, me fillimin e efekteve të ligjit nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”* (i ndryshuar), institucioni është përfshirë në proces ristrukturimi dhe punonjësit e tij janë pjesë e shërbimit civil, duhej vepruar në mënyrën e përcaktuar në nenin 50, pikat 1, 2 dhe 3, të këtij ligji.

Konkretisht, në bazë të pikës 3, të dispozitës së mësipërme, fillimisht duhej ngritur Komisioni i Ristrukturimit, i cili do të shqyrtonte mundësinë e sistemimit të çdo nëpunësi civil, në vendet e lira ekzistuese dhe do të paraqiste propozimet përkatëse për transferim të nëpunësit në një pozicion të lirë, të mundshëm, në të cilin ai plotëson kërkesat specifike.

Nëse do të ishte i pamundur sistemimi i të gjithë punonjësve ekzistues sipas kushteve të dispozitës së sipërpërmendur, është njësia përgjegjëse ajo që përpilon aktin e lirit, i cili duhet të shoqërohet me të drejtën për dëmshpërblim, si dhe me të drejtën për të konkurruar si nëpunës civil, nëpërmjet lëvizjes paralele, apo ngritjes në detyrë, për një periudhë 2 vjeçare.

Nga hetimi administrativ i kryer në lidhje me ristrukturimin, rezulton se, si në rastin e punonjësit ***** , ashtu dhe për punonjësit e tjerë të Komunës Zerqan, nuk është respektuar procedura e kërkuar prej nenit 50, pikat 1, 2 dhe 3, të ligjit nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”* (i ndryshuar), gjë e cila, në bazë të neneve 115/a, 116/c dhe 117/1, të ligjit nr. 8485, dt.12.5.1999, *“Kodi i Procedurave Administrative të RSH”*, e bën procesin të cënueshëm nga pikëpamja

procedurale dhe të pamundur për të prodhuar pasoja ligjore. Pra, Urdhri nr. 57, dt.12.08.2015, *"Për ndërprerjen e marrëdhënies së punës për punonjës me kontratë pune, për shkak të shkrirjes së Komunës Zerqan dhe ristrukturimit të Bashkisë Bulqizë"* është i paligjshëm, për shkak të mosrespektimit të procedurës ligjore dhe si i tillë, duhet të revokohet.

Për këto arsye

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11 pika 1 dhe 14, të ligjit nr.152/2013, *"Për nëpunësin civil"*, të ndryshuar, si dhe nenin 35, të Rregullores *"Mbi Procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit"* të miratuar me Vendimin nr.17, dt.11.03.2015,

V E N D O S A:

1. Të kërkoj nga njësia përgjegjëse që të drejtojë procesin e revokimit të aktit administrativ nr. 57, datë 12.08.2015, të Kryetarit të Bashkisë Bulqizë, *"Për ndërprerjen e marrëdhënies së punës për punonjës me kontratë pune, për shkak të shkrirjes së Komunës Zerqan dhe ristrukturimit të Bashkisë Bulqizë"*, për shkak të shkeljes së rëndë të procedurës të kërkuar nga ligji, në nxjerrjen e tij.
2. Në bazë të nenit 50, pika 3 e vijues, të ligjit nr. 152/2013, *"Për nëpunësin civil"*, i ndryshuar, njësia përgjegjëse të nxjerrë aktin administrativ për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit, i cili duhet të funksionojë dhe veprojë sipas përcaktimeve dhe afateve të Kreut II dhe III, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 171, dt.26.03.2014, *"Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil"*.
 - Përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil gjatë aplikimit të institutit të ristrukturimit, duhet të vendoset vetëm atëherë kur është i pamundur sistemimi i punonjësve që u është shkurtuar ose ristrukturuar pozicioni i punës.
 - Në këto raste, t'u njihet këtyre punonjësve e drejta e përfitimit prej pikave 7 dhe 8 të nenit të mësipërm, që ka të bëjë me dhënien e një shpërblimi në përputhje me vjetërsinë në shërbimin civil dhe mundësinë që brenda një periudhe 2 vjeçare, të konkurrojnë si nëpunës civilë për procedurat e lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, ose të emërohen në mënyrë të përkohshme, me pëlqimin e tyre, në pozicione të shërbimit civil, që lirohen përkohësisht, për shkak sëmundje, leje lindje e arsye të tjera ligjore.
 - Për ata punonjës që nuk plotësojnë kriterin arsimor, apo ndonjë kriter tjetër për të qënë nëpunës civil, të vepohet sipas pikës 7, të Kreut III, të Vendimit nr. 116, dt.05.03.2014, *"Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil, sipas ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil" (ndryshuar me VKM nr.532, dt.06.08.2014).*
3. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative lihet afat **30** ditë nga marrja dijeni për këtë vendim. Njësia përgjegjëse duhet të zbatojë vendimin duke u bazuar në rekomandimet e dhëna në pjesën arsyetuese të tij.

4. Me kalimin e këtij afati, të njoftohet me shkrim Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e vendimit.
5. Të njoftohen për këtë vendim, njësia e burimeve njerëzore në Bashkinë Bulqizë dhe punonjësi *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA